



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly


Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6.1 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare, të mbajtur më 22 dhjetor 2017, me propozimin e Grupit Parlamentar Lidhjes demokratike të Kosovës, nxjerr këtë:

DEKLARATË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës e dënon gjuhën fyese dhe të urrejtjes të përdorur nga përfaqësuesi i Organizatave të Veteranëve të Luftës së UÇK-së për vrasjet politike të veprimtarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga institucionet e drejtësisë që urgjentisht të ndërmerren të gjitha masat adekuate që vrasjet politike të veprimtarëve të LDK-së të trajtohen me seriozitet, me profesionalizëm dhe paanshmëri dhe të marrin dënimin e merituar.
3. Vetëm zbulimi i vrasjeve politike dhe i të gjitha krimeve të tjera të pandriçuara garanton zhvillimin e Kosovës si shtet, ku sundon ligji dhe e drejta dhe ku të gjithë qytetarët, pa dallim, ndihen të sigurt.

Nr. 06-D-001
Prishtinë, 22 dhjetor 2017

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Deklarata u dërgohet:

- Deputetëve të Kuvendit,
- Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe
- Arkivit të Kuvendit.